



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinas, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.04.2017, mori këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Daut dhe Beqir Krasniqi, nga fshati Grashticë - Komuna e Prishtinës.
- II. Prona e paluajtshme e Komunës që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesët e parcelës kadastrale nr. 1662-1, Zona kadastrale Çagllavicë, Certifikata e pronësisë P - 71914075-01662-1, e evidentuar si "pasuri shoqërore - rrugë", kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës kadastrale nr. 375-5, Zona kadastrale Çagllavicë, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë P-71914075-00375-5, në pronësi të pronarëve Daut dhe Beqir Krasniqi.
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues urban, kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të komunës dhe se kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelave kadastrale që do të këmbehen.

- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01-463/03-0093782/17 , më 24.04.2017



KRYESUESI I KUVENDIT

Halim Halimi, jur. i dpl.